



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.185 dt.15.12.1997

**PER
FINANCIMIN NGA TE ARDHURAT E BASHKISE
PER BLERJE LAVATRICESH.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.15.12.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit për financimin nga të ardhurat e Bashkisë për blerje lavatriçesh për çerdhet e fëmijëve dhe në mbështetje të nenit.14, të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, Ligjit Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”

VENDOSI

1. Dhënien e fondeve nga të ardhurat e Bashkisë për Drejtorinë e Qendrës Ekonomike të Çerdheve për :

- Blerjen e lavatriçeve tip shtëpiake me vlerë 1.500.000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Çerdheve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

